



BOJKOTON HETIMIN



Fatmir Rexhepi ka deklaruar se komisionarët e LDK'së nuk do të jenë të pranishëm sot në Qendrën e Numërimit të Votave, ku do të nisë procesi i hetimit të votave të Gjilanit. Kandidati i LDK'së për Kryetar të Gjilanit mendon se kjo komunë duhet të shkojë në rivotim, ashtu sikurse Prizreni dhe Lipjani. Deklaratat e tij mbështeten nga Zëvendëskryeministri Ramë Manaj. ■ f5



Ndryshimet paszgjedhore

Rifformatizimi i Qeverisë do të bëhet vetëm pas përfundimit të rrethit të tretë zgjedhor në Prizren dhe Lipjan. Udhërrëfyes për ndryshimet në Ekzekutiv, ndërkaq, do të jetë Raporti i Progresit i Komisionit Europian. Ish-Shefi i SHIK'ut, Kadri Veseli, konfirmon për Express se nuk pretendon të futet në Qeveri. ■ f6

Express

E mërkurë

06 janar, 2010

www.gazetaexpress.com

N° 1742, Viti III, Çmimi: 0.10 € • E përditshme e pavarur kosovare



Sërish në treg » Me leje te Inspektoratit

Në njërën anë, Inspektorati Sanitar i Kosovës u bën thirrje qytetarëve të mos i blejnë lëngjet serbe, por në anën tjetër ata lejojnë importuesit dhe përfaqësuesit e kompanive serbe që t'i importojnë edhe më tej produktet e njëjta. Express sjell dokumentin që u është shpërndarë dyqaneve. | FAQE 8-9

Vlon Mitrovica

Para se në Kosovë të vijë presidenti i Serbisë, takimit të presidentëve të rajonit dhe vizitës së admiralit Mark Fitzgerald, në Mitrovicë ndodh një shpërthim, një rrahje grupore dhe një djegie veture. Policia bën thirrje për vetëpërmbytje, sepse këto incidente kanë potencial të shndërrohen në trazira. | FAQE 7

KOMENT » Agjentët e provokimeve

Zotërinjtë Ives de Kermabon, Renzo Daviddi dhe Peter Feith duhet të tregojnë nëse janë apo nuk janë të aftë ta mbrojnë rendin dhe ligjin në Kosovë, si dhe qëllimet e BE'së për Kosovën. **Shkruan: Petrit Selimi** | FAQE 2



PËR DY JAVË

SHKATERROJNE 35 MILIONE EURO

Projekti për hapjen e Mihjes së Re të Sibovcit, me vlerë prej 35 milionë eurove - ka dështuar. Makineritë e rënda tash janë pjesërisht të demoluara. Inxhinierët fajësojnë menaxhmentin e KEK'ut, në krye me Arben Gjukën, që ka blerë makineri të vjetra - për të reja. I konsideruar si më i madhi në dy dekadat e fundit në Kosovë, ky projekt duket se është shkatërruar vetëm dy javë pas përfundimit. ■ f10-11

FOTO: ATDHE MULLA

DUO + + = 19.95€ në muaj!

HYNIN **n'ExpressOnline**
www.gazetaexpress.com

dukagjini
kompania e sigurimeve insurance company

Ekonomi

TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

VALA kalon mirë

Rreth 13.4 milionë SMS janë dërguar suksesshëm gjatë ditëve të festës së Vitit të Ri. Ndërkohë që vetëm gjatë kohës së pikut të Vitit të Ri, saktësisht në mes të datës 31 dhe 01 janë regjistruar mbi 6.8 milionë dërgesa të SMS-ve. E veçanta është se pas dhjetë vjet operimi, operatori Vala ka qenë 100 për qind e suksesshme dhe ka thyer të gjitha rekordet.

Krahasuar me vitin e kaluar, në po të njëjtën periudhë, VALA ka dyfishuar numrin e SMS-ve të dërguar të realizuar dhe ka inkasuar mbi 50 mijë euro më shumë, thuhet në komunikatën e PTK-së. Sipas saj, të hyrat e përafërta nga dërgimi i SMS-ve janë 150,000.00 euro (me TVSH), ndërkohë që mesatarja e SMS-ve të dërguar gjatë kohës me ngarkesë më të madhe (07:00 –

14:00) është 278,000 SMS në orë. "Të shikosh statistikat e thirrjeve dhe SMS-ve gjatë ditëve festive të Vitit të Ri, është me të vërtetë një rezultat rekord dhe kjo ndodh për herë të parë pas dhjetë vjetësh. Kjo tregon për punën e madhe të PTK-së në drejtim të komunikimit më të mirë dhe shërbime më kualitative", tha Shyqyri Haxha, kryeshef ekzekutiv i PTK-së.



SHKATER Për dy javë 35 MILI

Projekti 35 milionë euro për hapjen e Mihjes së Re të Sibovcit, ka dështuar. Makineritë e rënda tash janë pjesërisht të demoluara. Inxhinierët fajësojnë menaxhmentin e KEK-ut, në krye me Arben Gjukën, që ka blerë makineri të vjetra, për të reja. I konsideruar projekti më i madh në dy dekadat e fundit në Kosovë, ai duket se u shkatërrua vetëm dy javë pas përfundimit.

Zekirja Shabani

zekirja.shabani@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 5 JANAR — Një natë para festës së Vitit të Ri, projekti më i madh energjetik i Qeverisë së Kosovës në dy dekadat e fundit - ka dështuar.

Në mihjen e re të Sibovcit jugperëndimor që më 15 dhjetor ishte përfunduar vendosja e makinerisë së rëndë për nxjerrjen e qymyrit, të martën ekipi i gazetës Express, e ka gjetur pjesërisht të demoluara. Në dy linjat e shiritave të rinj transportues mungojnë 6 reduktorë dhe cilindra që duhej të vinin në lëvizje shiritat për bartjen e qymyrit nga mihja në termocentralet ekzistuese derisa të ndërtohet termocentrali Kosova e Re.

Punëtorët që për tri javë kishin



FOTOF: ATDHE MULLA

punuar në këtë pjesë të mihjes tregojnë se reduktorët janë bllokuar papritur dhe më 30 dhjetor janë dërguar për riparim.

"Është ndërprerë puna pasi kanë instaluar pajisje të vjetra. Vetëm i kanë ngjyrosur dhe i kanë marrë miliona euro, e tash shiritat nuk punojnë", tregon një nga inxhinierët e KEK-ut, i cili nuk pranon të përmendet emri. Ai akuzon kreun e KEK-ut, Arben Gjukën, për përzgjedhje të gabuar të kompanive që kanë ndërtuar këtë sistem.

Projekti në tërësi për vendosjen e makinerisë së rëndë, rehabilitimi i ekskavatorëve dhe punëve të tjera për hapjen e minierës, qe thënë se ka kushtuar 35 milionë euro, prej të cilave 16 milionë i ka dhënë Qeveria e Kosovës, kurse 18 milionë të tjera Ko-

misioni Evropian. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, pati thënë se ky projekt është një nga projektet më të mëdha në dy dekadat e fundit, që Kosova të ketë energji të mjaftueshme për vete dhe për eksport. Projekti për minierën e Sibovcit, sipas tij, ka përmirësuar makinerinë ekzistuese të rëndë të minierave të thëngjillit, e instaluar në vitin 1972, duke e bërë më stabile. Ndërkaq, zyrtarët e KEK-ut, pranojnë se ky sistem tani është ndalur për shkak të reduktorëve në stacionet vepruese.

Zëdhënësi i KEK-ut, Viktor Buzhala, thotë se këta reduktorë i ka hequr nga shiritat transportues prodhuesi dhe i ka dërguar në fabrikën ku janë prodhuar, sepse është vërejtur se ka pengesa në lidhjen në mes reduktorit dhe

Përplasjet për çelik

Kur bëhet fjalë për tregtinë me çelik, Kina dhe Amerika gjithmonë përplasen. Në fundi kjo ndodhi pasi Amerika aplikoi një taksë të veçantë doganore për eksportin e çelikut. Me këtë taksë do të goditen importet kineze në vlerë prej 2.7

miliardë dollarë në SHBA. Komisioni amerikan për Tregtinë Ndërkombëtare vendosi të rritë detyrimet doganore mbi importet e tubave kineze, të cilat përdoren kryesisht në industrinë e naftës dhe gazit. Ky veprim erdhi pas ankesave të paraqitura

nga U.S. Steel dhe gjashtë prodhuesve të tjerë të çelikut, si dhe sindikatës së punëtorëve të çelikut. Ndërmjet Kinës dhe SHBA-së ekzistojnë disa mosmarrëveshje tregtare në lidhje me qasjen e disa mallrave në tregje, duke filluar nga tregtia e mishit të pulës dhe gomave, e deri të filmat hollivudian.

PROJNË



tamburit. "Ekskavatorët e tjerë, të cilët nuk janë riparuar, punojnë. Tani nuk punon vetëm E-10B, i cili ishte inauguruar në dhjetor të këtij viti. Kompania e cila i ka hequr reduktorët ka premtuar se më 10.01.2010 do t'i sjellë reduktorët e riparuar", thekson Buzhala.

“ Është ndërprerë puna pasi kanë instaluar pajisje të vjetra. Vetëm i kanë ngjyrosur dhe i kanë marrë miliona euro, e tash shiritat nuk punojnë ”

Në anën tjetër, burime të Expressit tregojnë se këta reduktorë s' do të mund të hyjnë në punë minimum edhe gjashtë muaj.

Buzhala thotë se inaugurimi i këtij sistemi është bërë në dhjetor 2009, por jo edhe në komisionin përfundimtar. Pro-

jekti, sipas tij, gjendet në fazën e testimit dhe certifikata e komisionit do t'i jepet kontraktuesit kur të kryhen të gjitha obligimet kontraktuale në janar 2011.

Por, për të njëjtët shiritat që tani janë jashtë përdorimit, në vitin 2008, Korporata Energjetike e Kosovës ka shpenzuar 49.9 milionë euro për riparimin e tyre.

Në kontratën çelësa në dorë, e nënshkruar në nëntor të vitit 2008, mes KEK-ut dhe kompanive në konzorcium "Eko-Trade" nga Prishtina dhe "IMK 14 Oktobar" nga Serbia, thuhet se ka qenë i paraparë riparimi i Shiritave Transportues dhe Palosëseve për Largim të Djerinës - sistemi II dhe III. Burime të gazetës Express thonë se edhe reduktorët janë vendosur nga këto kompani, të cilat i kanë blerë ata në Bosnjë e Hercegovinë.

KEK-u tash sa kohë ka probleme me këto pajisje për shkak të tenderëve jo në rregull që po i aplikojnë.



NJOFTIM PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

Konform nenit 59 A të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë të shpallur me Rregulloren nr.2007/20

Nr. i Prokurimit: KEKO 09 143 121

I AUTORITETI KONTRAKTUES: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a
II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Nderprerës me mbrojtje termike

IV ANULIMI I PROCEDURËS

IV.1 Data e vendimit mbi anulimin e procedurës: 05.01.2010

IV.2 Numri i tenderëve të pranuar: shtata (7)

IV.3 Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik: Janë pranuar më pak se 3 tenderë të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje.

NENI V: ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit: (shifra adresën e plotë) Pr:Garibaldi

Në bazë të dispozitave të Tjetër VIII të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren nr.2007/20.

Versioni i plotë i Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit është në dispozicion në: www.ks-gov.net/krpp

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU AKTIVNOST NABAVKE

Po-članu 59 A Zakona br.02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Nabavka br. KEKO 09 143 121

I: UGOVORNI AUTORITET : KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA -DD
Ul."Nëna Tereze"br.36, Prishtina

II: PREDMET UGOVORA

II.1.1 Naslov ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet : Prekidači sa termičkom zaštitom

IV PROCEDURA OTKAZIVANJA – Otvorena procedura

IV.1 Datum odluke o otkazivanju procedure: 05.01.2010

IV.2 Broj primljenih tendera 7 (sedam)

IV.3 Razlog otkazivanja procedura javna nabavka: Primljena su manje od 3 odgovarajuća tendera ili zahteva za učešće

DEO V: ŽALBE

Svaka zainteresovana strana može da uložiti žalbu Telu za preispitivanje nabavke (adresa)Ul.Garibaldi

Po odredbama Dela VIII Zakona br. 02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Kompletna verzija Obaveštenja o Konkursu za Idejni Projekat je na raspolaganju : www.ks-gov.net/krpp



ORARI DITOR I FLUTURIMEVE DAILY FLIGHT SCHEDULE

E MËRKURË 06 JANAR 2010
WEDNESDAY, 06 JANUARY 2010

ARRITJA ARRIVAL	NGA FROM	PËR TO	SHKUARJA DEPARTURE	OPERATORI OPERATOR
/	PRISHTINA	VIENNA	07:05	AUSTRIAN AIRLINES
/	PRISHTINA	PODGORICA	07:15	MONTENEGRO AIRLINES
08:30	ZURICH	ZURICH	09:20	BELAIR
08:45	DUSSELDORF	DUSSELDORF	09:30	GERMANIA
09:00	ZURICH	ZURICH	09:45	EDELWISS
09:30	DUSSELDORF	DUSSELDORF	10:15	AIR BERLIN
/	PRISHTINA	TIRANA	10:30	BELLE AIR
10:15	MUNCHEN	MUNCHEN	11:15	HAMBURG INT'L
10:45	DUSSELDORF	STUTT GART	11:45	XL AIRWAYS
12:25	STUTT GART	STUTT GART	13:05	GERMANWINGS
12:30	VIENNA	VIENNA	13:15	AUSTRIAN
13:25	ISTANBUL	ISTANBUL	14:20	TURKISH AIRLINES
14:20	LONDON	LONDON	15:00	BRITISH AIRWAYS
14:30	BUDAPEST	BUDAPEST	14:15	MALEV
14:45	TIRANA	TIRANA	15:30	BELLEAIR
15:00	LJUBLJANA	LJUBLJANA	15:45	ADRIA AIRWAYS
15:40	VIENNA	VIENNA	16:35	AUSTRIAN AIRLINES
16:30	DUSSELDORF	DUSSELDORF	17:15	AIR BERLIN
16:45	FRANKFURT	MUNCHEN	17:45	HAMBURG INT'L
17:45	STUTT GART	STUTT GART	18:30	GERMANIA
18:05	STUTT GART	DUSSELDORF	19:05	XL AIRWAYS
19:30	TIRANA	/	/	BELLEAIR
19:45	PODGORICA	/	/	MONTENEGRO AIRLINES
23:10	ZAGREB	/	/	CROATIA AIRLINES
01:20	LJUBLJANA	/	/	ADRIA AIRWAYS